



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN  
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:  
DREJTIMI MËSIMOR “PËRPUNIM DRURI”**

**Janar, 2015**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “Përpunim druri”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Përpunim druri”, Niveli I, “Përpunim druri (pilot-PEM)”, Niveli I, “Përpunim druri i kombinuar (pilot-PEM)”, Niveli I; në profilin “Mobileri dhe tapiceri”, Niveli II dhe në profilin “Prodhime druri gjysëm të gatshme”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.”

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor **“Përpunim druri”** do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të **“Teorisë profesionale të integruar”** në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar **“Teori profesionale e integruar”**, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor **“Përpunim druri”**, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Materiale për prodhimin e objekteve prej druri, kl. 10.
2. Materiale për prodhimin e objekteve prej druri, kl. 11.
3. Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit, kl. 10.
4. Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit, kl. 11.
5. Ndërtimi i objekteve prej druri, kl. 10.
6. Ndërtimi i objekteve prej druri, kl. 11.
7. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12.
8. Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit, kl. 13.
9. Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti, kl. 13.
10. Teknika e tharjes dhe transporti i brendshëm, kl. 13.
11. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Materiale për prodhimin e objekteve prej druri	61	20
2	Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit	46	15
3	Ndërtimi i objekteve prej druri	36	12
6	Bazat e sipërmarrjes	19	6
7	Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin	15	5

	e drurit"		
8	Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti	52	18
9	Teknika e tharjes dhe transporti i brendshëm	57	19
10	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
	<b>TOTALI</b>	<b>300</b>	<b>100%</b>

Temat sipas lëndëve janë:

- a) **“Materiale për prodhimin e objekteve prej druri”, kl.10 dhe kl. 11: (61 orë)**
- Lënda e sharruar 5 orë
  - Prodhime gjysmë të gatshme 2 orë
  - Pllaka e zdrukthit dhe e fibrës 8 orë
  - Materialet për r ngjitje 12 orë
  - Materiale të lyerjes dhe ilustrimit të mobiljes 22 orë
  - Materialet e tapicerisë 12 orë
- b) **“Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit”, kl.10 dhe kl.11: (46 orë)**
- Makinat e sharrimit të drurit 15 orë
  - Makinat plan-drejtuese 15 orë
  - Makina frezë me bosht vertikal nga poshtë 8 orë
  - Makinat e shpimit të drurit 8 orë
- c) **“Ndërtimi i objekteve prej druri”, kl.10 dhe kl.11: (36 orë)**
- Objektet prej druri të mjediseve të banimit 16 orë
  - Objekte prej druri për institucione 8 orë
  - Objekte druri të tapicuara 12 orë
- d) **“Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12: (20 orë)**
- Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor 4 orë
  - Sipërmarrja dhe biznesi 6 orë
  - Tregu dhe sjellja konsumatore 5 orë
  - Legjislacioni i punës 5 orë
- e) **“Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”, kl.13: (15 orë)**
- Njohuri për ligjet urbanistike për vendndodhjen e repartit/fabrikës të përpunimit të drurit ndaj zonës të banuar 4 orë
  - Njohuri për ligjet në mbrojtje të shëndetit të punëtorëve në fushën e përpunimit të drurit 3 orë
  - Njohuri për strukturën e një biznesi të përpunimit të drurit 4 orë

- Njohja e ligshmërisë për marrëdhëniet sipërmarrës-investitor-klient në përpunimin e drurit 4 orë

**f) “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti”, kl.13: (52 orë)**

- Analiza e prodhimit të objektit prej druri 3 orë
- Analiza dhe përpunimi i vizatimeve të objektit prej druri 6 orë
- Llogaritja e materialeve për prodhimin e objekteve prej druri 4 orë
- Përcaktimi i kostos së prodhimit të objektit prej druri 4 orë
- Magazinimi i objekteve prej druri 3 orë
- Teknologjia e prodhimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme 4 orë
- Makineritë, pajisjet dhe materialet për prodhimin e objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme 7 orë
- Prodhime speciale prej druri dhe vozat 6 orë
- Teknologjia e prodhimit të parketit 7 orë
- Makina të avancuara të përpunimit të drurit 8 orë

**g) “Teknika e tharjes dhe transporti i brendshëm”, kl.13: (57 orë)**

- Vetitë e avujve të ujit dhe ajrit si mjet tharës 3 orë
- Dukuritë fizike dhe vetitë e drurit gjatë tharjes 4 orë
- Tharja natyrore dhe artificiale 6 orë
- Regjimi në tharjen e drurit 4 orë
- Metoda të tjera të tharjes të drurit 4 orë
- Treguesit tekniko-ekonomikë të tharjes 4 orë
- Makinat peshëngritëse 8 orë
- Makina dhe instalime transporti me organe tërheqëse 8 orë
- Makina dhe instalime transporti pa organe tërheqëse 8 orë
- Transporti pneumatik 8 orë

**i) Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13: (14 orë)**

- Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor 3 orë
- Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis 3 orë
- Zhvillimet demografike dhe mjedisi 4 orë
- Shoqëria e konsumit dhe mbetjet 4 orë